



Prishtinë, 24.11.2015

## **Reagim ndaj shkatërrimit të ndërtesës së banimit në Prishtinë, aset i përfshirë në Listën e Trashëgimisë Kulturore në mbrojtje të përkohshme**

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK), organ ligjor për vlerësim dhe shpalljen e aseteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përhershme, shpreh shqetësimin rreth dëmtimeve dhe degradimit sistematik të Qendrës Historike në Prishtinë, duke theksuar rastin e rënimit të bërë para disa ditëve të ndërtesës *Shtëpi banimi e shek XX* në pronësi të Hajdar Riza.



Shtëpia e banimit shek XX në pronësi të Hajdar Rizës

Ndërtesa e banimit Hajdar Riza, kuadër ndërtimor në Qendrën Historike të Prishtinës është aset i trashëgimisë arkitekturore i regjistruar me numrin unik 002709 në Bazën e të Dhënave të MKRS, dhe i përfshirë me nr. rendor 965 në Listën e Trashëgimisë Kulturore në mbrojtje të përkohshme, të miratuar nga Ministri i MKRS me 09.10.2015.

Asetet e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme gëzojnë status të mbrojtjes ligjore, ruajtja e të cilave i nënshtrohet normativës së përcaktuar në Ligjin nr. 02/1-88 për Trashëgimi Kulturore. Në këtë kuadër, dëmtimi apo shkatërrimi i aseteve të trashëgimisë kulturore përcaktohet si veprim i ndaluar, dhe sanksionohet sipas Kodit Penal të Kosovës dhe Ligjit për Kundërvajtje (Ligji nr. 02/1-88 për Trashëgimi Kulturore, neni 4.11 dhe 11.2).

Me qëllim parandalimi të degradimit apo humbjes së trashëgimisë kulturore, KKTK kërkon urgjentisht nga institucionet kompetente të ndërmarrin masat ligjore ndaj të gjithë personave fizik dhe juridik të cilët e rrezikojnë, dëmtojnë apo shkatërrojnë asetet e trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës.

Në drejtim fuqizimi të sanksioneve ligjore ndaj të gjitha rasteve të dëmtimit apo shkatërrimit të qëllimshëm të trashëgimisë kulturore, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore do të ndërmarr veprimet e duhura.